

SHPALLJE VEND VAKANT BASHKIA ELBASAN

TERMAT E REFERENCËS PËR THIRRJEN ME OBJEKT "PSIKOLOGE/PUNONJËSE SOCIALE OSE INFERMIERE"

Forum i Gruas Elbasan (FGE) fton individë të interesuar në profesionin "PSIKOLOGE/PUNONJËSE SOCIALE ose INFERMIERE" të aplikojnë për të punuar në strukturat e FGE (me kohë të plotë) me detyrë parësore Strehëzën e Emergjencës.

PERSONI I PËRZGJEDHUR DUHET:

- Të ruaj fshehtësinë e identitetit dhe të dhënave personale të përfitueseve;
- Të zbatojë orarin dhe grafikun e punës;
- Të ruaj dhe të mirëmbajë pajisjet që i vihen në dispozicion për zhvelimin e projektit;
- Të zbatojë me përpikmëri standartet e Strehëzës së Emergjencës;
- Të ofrojë një shërbim cilësor psiko-social;
- Të krijojë kushte favorizuese në bashkëpunimin me Qendrën e Këshillimit dhe Studion Avokatore të FGE- së;
- Të bashkëpunojë me strehëzat respektive për rastet.
- Të referojë përfitueset të përfitojnë shërbime të tjera në institucione të tjera publike dhe OJF;
- Të përgatisë për çdo fund muaj raportin narrativ si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga donatorët e Projektit;
- Të ofrojë ekspertizën në fushën psiko-sociale për njohjen dhe zbatimin e të drejtave të grave në organizimin e trajnimeve, takimeve ndërgjegjësuese, sesioneve fuqizuese dhe aktivitete të tjera;

KAPACITETI TEKNIK PROFESIONAL

- Të ketë diplomë Universitare me titullin Përkatës

- Përparësi do të jenë:
 - kualifikime dhe trajnime në fushën profesionale (me çertifikata), të bëra brënda apo jashtë vëndit
 - eksperiencë të mëparshme pune në profesion, minimumi një vit
 - zotërim patente Tipi B
 - njohja e gjuhës angleze

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Forumit të Gruas Elbasan:

- ❖ CV-në
- ❖ Fotokopje diplome dhe/ose çertifikata të tjera nëse ka
- ❖ Një referencë (bashkë me kontakte) nga një punëdhënës i mëparshëm nëse ka

Kërkesa për shprehje interesi do të qëndrojë e hapur për 7 (shtatë) ditë kalendarike, në web-in Forumit të Gruas Elbasan, www.forumigruaselbasan.org dhe Facebook <https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/>.

Shprehjet e Interesit duhet të dorëzohen pranë FGE me postë ose me e-mail deri me datë **10.09.2023, ora 16:00**. (Adresa postare: Lagja “Luigj Gurakuqi”, Rruga “11 Nëntori”, Pallati 70, Sh 2, Apt.3 ose në adresën e e-mailit: forumigruaselbasan1991@gmail.com).

Në rast se paraqitet një ofertë e vetme e cila i përmbush të gjitha kriteret e sipërpërmenduarat, atëherë kandidatja shpallet automatikisht fituese. Të interesuarit mund të marrin informacion të mëtejshëm në adresën e mëposhtme: forumigruaselbasan1991@gmail.com ose [tel 0696511674](tel:0696511674).

Të drejtat dhe detyrimet e kandidatës fituese do të përcaktohen me kontratë.